

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Prishtinë, 18 mars 2015

PROMOVIMI I BOTIMEVE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

1. Anton Kolë Berishaj

Shoqëria Pa Shtet

Studim Socio-Antropologjik

Autori Berishaj në këtë studim të mbarështruar në 274 faqe, të ndarë në 14 kaptina dhe 57 nënkaptina ka aplikuar qasje multidisiplinare në trajtimin socio-antropologjik të një mjedisi shqiptar. Ky trajtim qartëson tërë kompleksitetin e formave dhe mënyrave të organizimit vetanak, sistemin specifik të vlerave, lidhjen organike me traditën dhe normat zakonore, mitin e familjes, vatrës, shtëpisë, besimin dhe besëtytnitë, komunikimin me grupet e tjera, destruktivitetin dhe simbiozën që krijon komunikimi i një shoqërie të vetorganizuar shqiptare. Kjo formë daton që nga vendosja e sistemit të timarit, që territorialisht dhe nominalisht i përkisnin Perandorisë Osmane, mirëpo që realisht e organizuan jetën jashtë kontekstit ligjor të sajë, me forma të së drejtës zakonore, që përkon me modelin segmentar të jetës. Organizimi familjarë, barku, vëllazëria, fisi dhe lidhja fisnore, mbështeten mbi bazën e normave të së drejtës të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Sistemi i vlerave, mekanizmat shoqëror që e kompensojnë funksionimin e shtetit të organizuar politik dhe ndjenja e përkatësisë së një trugu të përbashkët, shndërrohen në mekanizma homogjenizues. Ndërsa ekonomizimi dhe sigurimi i mbijetesës në ambientin malor, shndërrohet detyrimisht në segmentarizëm shoqëror.

Libri i Anton Berishajt, *Shoqëria Pa Shtet*, veç rëndësisë shoqërore për trajtimin e një fenomeni socio-kulturor ka edhe vlera të një modeli të cilin studiuesit e ri të kësaj disipline mund ta përdorin në projektet e tyre hulumtuese, në mjedise të ndryshme të shoqërisë shqiptare, ku format e organizimit të jetës mbi normat e traditës kanë qenë prezente deri në ditët tona.

2. Arsim Bajrami

Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar

Studimi monografik *Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar*, paraqet një kontribut shkencor nga e drejta kushtetuese, i cili trajton konstitucionalizmin shqiptar në harkun kohor 100

vjeçar, përkatësisht nga viti 1912 e deri me 2012. Konstitucionalizmi shqiptar sipas autorit, në esencë tregon emancipimin shtetëror dhe ndërtimin e traditës shtetërore të kombit shqiptar. Autori problematikën në këtë studim e vështron duke e hulumtuar konstitucionalizmin si proces shtetëror në një anë, dhe në anën tjetër, traditën kushtetuese të Shqipërisë, Kosovës dhe përvojat kushtetuese në Maqedoni.

Studimi kap një vëllim prej 572 faqesh dhe si i tillë paraqet një kontribut me rëndësi shkencore për konstitucionalizmin. Botimi ndahet në katër pjesë, të cilat përbëjnë një tërësi unike. Pjesa e parë i kushtohet zhvillimit të konstitucionalizmit në Republikën e Shqipërisë, pjesa e dytë atij në Kosovë dhe pjesa e tretë përfshinë Maqedoninë, përkatësisht hapësirën ku jetojnë shqiptarët. Në pjesën e katërt jepen tendencat bashkëkohore në zhvillimin e konstitucionalizmit në kushtet e integriteteve evropiane dhe atyre kombëtare. Vlerë të veçantë të këtij botimi paraqet shtojca me pjesë dokumentesh të rëndësishme që autori i ka përzgjedhur me qëllim që t'u shërbejnë specialistëve të fushës por edhe kureshtjes së opinionit të gjerë lexues.

3. Edi Shukriu

Hyjnesha Dardane

Autorja përmes trajtimit multidisiplinar shkencor në këtë studim sjell në pah njërin nga hyjnitë më të respektuar të panteonit dardan. Libri përfshin studimin e kultit dhe të religjionit dardan, si çështje me shumë interes në kuadër të studimeve ilire dhe të antikitetit të rajonit. Në të përcillen fazat e zhvillimit të besimit dhe niveli i krijuar i sistemit religjioz dardan, në të cilin Hyjnesha Dardane fitoi edhe pozitë superiore në fazat e mëvonshme të besimit dardan. Libri ka 190 faqe dhe përveç parathënies, trajton paraqitjen e të gjitha monumenteve përkushtuar Hyjneshës Dardane, analizën e tyre, si dhe zhvillimin e besimit dardan në parahistori dhe antikë. Teksti paraqitet me fotografi cilësore, skica, harta, literaturë dhe indeksin e emrave. Studimi monografik Hyjnesha Dardane e autores Edi Shukriu, është një kontribut i vlefshëm për njohjen e një figure të historisë antike te ne.

4. Ekrem Murtezai

Hyrje Konceptuale në Filozofi

Në botimin Hyrje Konceptuale në Filozofi, autori Murtezai e përvijon mendimin filozofik që nga etimologjia e tij, duke e shtrirë natyrshëm nëpër periudha të cilat jo gjithëherë janë të lehta të përthekohen. Problematikën konceptuale të filozofisë autori e mbarështron në 390 faqe tekst, të cilin në aspektin metodologjik e ndanë në 16 kapituj.

Strukturimi i veprës ndjek kronologjinë e natyrshme të zhvillimit të mendimit filozofik, duke analizuar kushtet sipas etapave në të cilat është bërë i mundshëm ky zhvillim – prej filozofisë së lashtë greke e deri te ajo bashkëkohore. Edhe sipas mendimit të recensentëve të këtij botimi duhet nënvizuar së paku dy çështje:

1. Vepra ofron qasje të mirëfilltë shkencore, trajtim kronologjik, sistemim dhe mbarështrim logjik të çështjeve të ndërlydhura në kohë e në hapësirë, dhe
2. Botimi padyshim përmbushë mungesën evidente të literaturës së mirëfilltë shkencore për ata që mëtojnë të njohin kronologjinë, zhvillimin e rrethanave shoqërore e historike të menduarit filozofik.

5. Grup autorësh

Gërmime dhe Studime Arkeologjike në Kosovë 2000-2012

Gërmime dhe studime arkeologjike është përmbledhje e punimeve të grupit të autorëve nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët kanë kryer gërmime arkeologjike në territorin e Kosovës nga viti 2000 deri më 2012. Kjo përmbledhje, përpos hyrjes, ka 17 artikuj si: 10 vjet kërkime në Kosovë; Vendbanimi prehistorik i Vlashnjës; Tumat e Llashticës, të Dhëna të reja mbi epokën e bronzit në Kosovë; Varrezat Tumulare Dardane të Shqipërisë Verilindore; Simbole Ilire në maskat prej ari të Ohrit; Mbishkrime të reja Latine nga Kosova; Vështrim mbi historikun e gërmimeve arkeologjike në Ulpianë; Terma Romake e shek. II-IV në Çiflak; Objekte plastike të periudhës romake, Ndërtimet mbrojtëse të perandorit Justinian në Provincën e Dardanisë; Të dhëna të reja mbi mesjetën e hershme në Kosovë; Gërmime të vitit 2004 në Kalanë e Prizrenit dhe Varreza mesjetare në Banjë të Malishevës. Përmbajtja e kësaj vepre shtrihet në 398 faqe.

6. Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi

Popullsia dhe Vendbanimet Shqiptare në Luginën e Preshevës

Botimi i monografisë prej 640 faqesh, Popullsia dhe Vendbanimet Shqiptare në Luginën e Preshevës, është kontribut i vlefshëm i dy autorëve, të cilët duke vërejtur mungesën e studimeve të kompletuara për një entitet të veçantë etniko-politik siç është Lugina e Preshevës, iu kanë qasur studimit të mirëfilltë të dinamikës, strukturës së popullsisë dhe vendbanimeve shqiptare. Autorët duke trajtuar me përkushtim dhe akribi shkencore vendbanimet, tipologjinë dhe proceset transformuese, ku shqiptarët kanë një shtrirje territorialisht kompakte, vijnë në përfundim se kjo zonë e trojeve tona ka mbetur në një pozitë mjaft të vështirë sa i përket perspektivës historike të së ardhmes.

Bashkëautorët Islami dhe Ejupi, mbi bazën e të dhënave dhe fakteve, kanë analizuar dhe shpjeguar ndikimin e një kompleksi rrethanash në krijimin e një tabloje karakteristike demografike të popullata shqiptare. Ata vijnë në përfundimin se popullata shqiptare e Luginës paraqet transicionin e fundit demografik në Evropë. Botimi me rezultatet e qëndrueshme që kanë nxjerrë autorët, mbi bazën e analizës së të dhënave relevante, argumenteve dhe trajtimit me një metodologji bashkëkohore, është i dobishëm për opinionin profesional, posaçërisht për hulumtuesit nga fusha e shkencës mbi popullsinë. Ky studim mund të shërbejë si burim informacioni jo vetëm për rrjedhat demografike, por edhe për problemet e vendbanimeve dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Botimi, me argumentimin që përmban përveç vlerave të

qëndrueshme shkencore, do të jetë padyshim edhe në funksion të sensibilizimit të çështjes së shqiptarëve të Luginës, si një problem që kërkon zgjidhjen e drejtë në të ardhmen.

Autorët studimin e tyre në aspektin metodologjik e kanë mbarështuar në parathënie, tetë pjesë të veçanta, rezymeja, literatura dhe burimet si dhe indeksi i emrave. Studimi është i pajisur me harta origjinale, tabela dhe grafikone të shumta që ilustrojnë dhe shpjegojnë përmbajtjet e caktuara të tekstit. Ky botim do tu shërbej edhe specialistëve të rinj të kësaj fushe si model për trajtimin e temave të ngjashme.

7. Jusuf Osmani dhe Ramë Manaj

Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010

Botimi Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010, është përmbledhje dokumentesh për ndarjen territoriale të Kosovës gjatë periudhës 65 vjeçare. Është kjo kohë e ndryshimeve të mëdha shoqërore e politike në Kosovë, e cila ka determinuar edhe format e ndarjes administrative e territoriale. Kjo tërësi dokumentesh përpos hyrjes, ka këta kapituj: Ndarja administrative-territoriale e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në këshilla popullore të rretheve dhe këshilla popullore të vendeve, Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në këshilla popullore të komunave, rretheve dhe qyteteve, Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në komuna dhe organizimi territorial pas suprimimit të autonomisë së Kosovës me 1998.

Botimi i këtij dokumentacioni është mbarështuar në një vëllim prej 325 faqesh dhe si i tillë paraqet një bazë të mirë dokumentare e metodologjike për studiues të ri në këtë fushë studimi.

8. Pajazit Nushi

Leksikoni i Psikologjisë I dhe II

Leksikoni i Psikologjisë është botim mjaft voluminoz i ndarë në dy vëllime, që mbarështon një materie interesante në 1130 faqe. Vëllimi i parë ka 550 faqe, ndërsa vëllimi i dytë 580 faqe. Leksikoni trajton 5232 zëra të psikologjisë bashkëkohore të nxjerrë nga literatura e psikologjisë më të re, ku psikologjia kognitiviste dhe psikologjie fiziologjike ka pasur ndryshime të mëdha. Përmbajtja e këtij teksti përfshinë zërat e rinj nga zhvillimi i psikologjisë, ndërsa zërave të përgjithshëm u janë shtuar zërat që bëjnë fjalë për specifikat shqiptare. Për nga shtrirja përmbajtjesore, zërat janë ndarë në tri grupe: zërat e gjatë, zërat e mesëm dhe zërat e shkurtër. Për secilin nga zërat e gjatë dhe të mesëm është dhënë literatura burimore e përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Zërat nga psikologjia e motivacionit e iluzioneve, e motorikës dhe e bazës biologjike të sjelljeve të njeriut kanë ilustrime grafike. Ilustrime grafike kanë edhe zërat e psikometrisë. Autorët e zërave janë dhënë në gjuhën burimore me vitet e lindjes dhe të vdekjes të tyre dhe njëkohësisht emri dhe mbiemri i secilit është transponuar në gjuhën shqipe. Vepra përmban indeksin e termave, indeksin antropologjik dhe pasqyrën përmbledhëse të shkollave psikologjike.

Leksikoni i Psikologjisë i Pajazit Nushit, është një studim analitik, gjithëpërfshirës në fushën e terminologjisë psikologjike. Si i tillë është një kontribut i rëndësishëm që plotëson vakumin në literaturën shkencore në gjuhën shqipe.

9. Revista Studime Shoqërore Nr. 1

Që nga viti 2014 Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-ut nxori numrin e parë të revistës Studime Shoqërore, në të cilën u botuan studime, trajtesa, recensione dhe kritika nga disiplinat e shkencave shoqërore. Në këtë numër që kap një vëllim prej 335 faqesh, kontributet e tyre shkencore i kanë publikuar 16 autorë.

Revista hapet me fjalën e redaksisë, për të vazhduar me studime dhe trajtesa, ligjëratën inauguruese, tre recensione e kritika dhe mbyllet me kronikën e ngjarjeve dhe të aktiviteteve të Akademisë për vitin 2013.

Sekretari i Seksionit
Jusuf Bajraktari